



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT
“MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2026.**

Regjistrimi i kandidatëve “Mësues për Shqipërinë” 2025 bëhet në **e-albania** në shërbimin “**Aplikim për konkurrim për punësim si mësues**”.

Afati për aplikim është **nga data 01.06.2026 deri në datën 15.06.2026, ora 24:00 (15 ditë)**

Për kandidatët që do të marrin pjesë në provimin e licencës pas datës 15.06.2026 deri më 26.06.2026, afati i aplikimit është nga data 15.06.2026 deri më 27.06.2026.

- ✓ Kandidati aplikon në DRAP-in ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në 3 (tri) ZVAP ku dëshiron të punësohet, brenda DRAP-it ku ka vendbanimin e përhershëm.
- ✓ Të gjithë kandidatët për mësues, (kandidatët që kanë qenë pjesëmarrës në portalet e mëparshme dhe kandidatët e rinj), kanë detyrim të ngarkojnë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, përjashtohen nga konkurrimi dhe hiqen nga lista e portalit.
- ✓ Kandidati që ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe dëshiron të marrë pjesë në testim do të renditet në listën përfundimtare me pikët e testimit të fundit. Kandidati, i cili nuk dëshiron të marrë pjesë në testimin e radhës, i mbarten pikët egzistuese në renditjen e re, deri në 2 (dy) vite.
- ✓ Kandidati që zotëron më shumë se 1 (një) licencë, ka të drejtë të konkurrojë në profilet sipas licencave përkatëse, duke bërë aplikim më vete për secilën licencë.
- ✓ Kandidati që dëshiron të punojë si mësues në dispozicion ose si mësues ndihmës, krahas aplikimit për profilin përkatës, në aplikimin e tij duhet të zgjedhë edhe opsionin “Mësues në dispozicion” ose “Arsim special”.
- ✓ Kandidati, i cili ka dhënë provimin e licencës për profilin që aplikon dhe ka rezultuar i suksesshëm, si dhe testimin për portalin “Mësues për Shqipërinë”, përzgjedh nëse do të ruajë pikët e testimit apo kërkon të ritestohet për këtë portal.
- ✓ Kandidati, i cili nuk ka detyrim licencimit sipas përcaktimeve ligjore dhe kandidati i arsimit parashkollor, do të zgjedhë opsionin “Dëshiroj të vazhdoj pa licencë”, për të vijuar më tej aplikimin.
- ✓ Kandidatët që kanë kryer provimin e licencimit dhe kanë kaluar me sukses atë, si edhe kanë zhvilluar në të njëjtën ditë edhe testimin e informatizuar, për të konkurruar për pjesëmarrje

në portalin “Mësues për Shqipërinë”, duhet të ngarkojnë në e-albania brenda afatit të përcaktuar dosjen përkatëse me dokumentet e kërkuara.

- ✓ Kandidati që nuk zgjedh të marrë pjesë në testimin e informatizuar në të njëjtën ditë në të cilën jep provimin e licensimit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, i nënshtrohet procedurave të konkurrimit, sipa rregullave të parashikuara në këtë udhëzim.

Dokumentacioni i aplikimit:

Të gjithë kandidatët për mësues, përfshirë dhe parashkollorin (*kandidatët që kanë qenë pjesëmarrës në portalet e mëparshme dhe kandidatët e rinj*), kanë detyrim të ngarkojnë online dosjen për konkurrim, në të kundërt, përjashtohen nga konkurrimi dhe hiqen nga lista e portalit.

1- Dokumentet që ngarkohen nga kandidati janë:

- a) **Diplomë/a** për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe **listën e notave**, (të detyrueshme për t'u ngarkuar).
- b) Libreza e punës e plotësuar deri në momentin e aplikimit. (*nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë*).
- c) Vërtetim për vijimësinë në punë për kandidatët të cilët nuk i kanë të shkëputura marrëdhëniet e punës.
- d) Dëshmi të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtrë” (*nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë*).
- e) Çertifikata me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Çertifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MA, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara. (*nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë*).
- f) Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (*nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet*).
- g) Çdo dokument tjetër që disponon, që sipas shtojcës 1, të udhëzimit nr. 8, datë 3.05.2024, vlerësohet me pikë, të cilat nuk janë të detyrueshme;

Faza e parë: Vlerësimi i dosjeve të aplikimit:

1. KVD bën vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për plotësimin e kriterëve ligjore, nga 15.06.2026 deri 03.07.2026 (15 ditë pune).
2. Lista paraprake shpallet në datën 06.07.2026 në faqen zyrtare të AKAP dhe DRAP.
3. Kandidatët bëjnë ankimimin për vlerësimin me pikë dhe verifikimin e dosjeve për kualifikim, nga data 06.07.2026 deri më 08.07.2026.
4. KVD shqyrton ankesat dhe konfirmon kandidatët e kualifikuar, të cilët futen në testim apo mbartin pikët e portalit 2025, deri më 15.07.2026.

Faza e dytë: Testimi i informatizuar:

- I. QSHA harton kalendarin dhe zhvillon testimin e informatizuar brenda datës 25.08.2026. Kalendarin e testimit të informatizuar publikohet në faqet zyrtare të AKAP, DRAP dhe QSHA.
- II. Kandidati ankimon në QSHA dhe për dijeni AKAP, brenda 3 ditë pune nga marrja e rezultatit. QSHA, brenda 5 ditë pune e shqyrton, i kthen përgjigje ankuesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve, kur pranohet ankesa.
- III. QSHA nxjerr rezultatet e testit të informatizuar brenda datës 31.08.2026.

Faza e tretë: Lista përfundimtare

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar së bashku me renditjen e tyre publikohet në faqet zyrtare të AKAP/DRAP brenda datës 02.09.2026.

Sqarim!

- *Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar në aplikim, nuk kualifikohet.*
- *Për çdo kandidat që aplikon, sistemi përzgjedh në mënyrë automatike DRAP-in në të cilin do të shqyrtohet dosja, mbështetur në të dhënat e marra nga e-Albania, për vendbanimin e tij.*
- *Kandidati përzgjedh DRAP-in dhe tri prej ZVAP-ve brenda DRAP-it ku ka vendbanimin e përhershëm në të cilat dëshiron të aplikojë, si edhe profilin për të cilin është diplomuar dhe / ose licencuar.*
- *Kandidatët që kanë dhënë testimin e informatizuar për konkurrimin në portalin "Mësues për Shqipërinë" para vitit 2024, nuk mund të mbartin pikët e testit, por duhet të zgjedhin për të marrë pjesë në testimin e informatizuar*
- *Gjatë aplikimit, kandidati konfirmon vërtetësinë e të dhënave si edhe vetëdeklaron gjendjen e tij gjyqësore.*

*Për çdo paqartësi ose sqarim, kontaktoni DRAP-in ku keni vendbanimin e përhershëm:

DRAP Tiranë - DRAPTirane@arsimi.gov.al

DRAP Durrës- DRAPDurres@arsimi.gov.al

DRAP Fier - DRAPFier@arsimi.gov.al

DRAP Korçë - DRAPKorce@arsimi.gov.al

DRAP Lezhë - DRAPLezhe@arsimi.gov.al

SHTOJCË 1

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to.</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë. Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë. Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë. Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë. Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë. Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë. Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë. Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë. Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 7 pikë. Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 10 pikë.</p>	0.5-10 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1-2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 2 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>b) Mësues Specialist (kategoria II) 3-4 pikë (3 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 5 pikë</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”.</p> <p>Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron.</p>	0-5 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë. c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas Udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p>	0-2 pikë

	<p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p>	
4	<p>Trajnime:</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>a. 1 kredit =1 pikë.</p> <p>b. 2 kredite =2 pikë.</p> <p>c. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor.</p>	0-10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)